




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të nenit 58 pika h.) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28 të datës 4 qershor 2008 dhe nenit 40 pika h.) të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kryetari i Komunës propozon që:

Në mbështetje të nenit 12 dhe 17, pika o) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008 , Ligjit nr.04/L-071 për sistemin e adresave, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.29 e datës 27 dhjetor 2011, nenit 9 shkronja o) dhe nenit 20 par. 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, në mbledhjen e vet të mbajtur me datë _____2026 të miratojë këtë:

PROPOZIM

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR EMËRTIMIN E RRUGËVE TË REJA, SHESHEVE DHE HAPËSIRAVE PUBLIKE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË LIPJANIT

I. Me këtë Vendim, formohet Komisioni për emërtimin e rrugëve të reja (të pa emërtuara), shesheve dhe hapësirave publike.

II. Komisioni formohet në në përbërje si vijon:

1. Imri Semetishti, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Kryesues
2. Burim Rrustemi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport anëtar
3. _____ anëtar i kuvendit nga subjekti politik LDK, anëtar/e
4. _____ anëtar i kuvendit nga subjekti politik LDK, anëtar/e
5. _____ anëtar i kuvendit nga subjekti politik PDK, anëtar/e
6. _____ anëtar i kuvendit nga subjekti politik LVV, anëtar/e

7. Kryetari/a e fshatit, lagjes urbane përkatëse në të cilin emërtohen rrugët , anëtar/e;
8. Jetmir Bytyqi , zyrtar në Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtar .

II. Detyrë e Komisionit është që të bëj identifikimin dhe të propozoj emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike. Për kryerjen e këtyre detyrave, Komisioni konsultohet me këshillat e fshatrave dhe lagjeve urbane përkatëse.

III. Komisioni pas përfundimit të punëve, do të hartojë Propozim-Vendimin për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike në territorin e Komunës së Lipjanit.

IV. Propozim Vendimi i hartuar nga Komisioni do të kalojë përmes Zyrës së Kryetarit të Komunës dhe do të dërgohet për miratim në Kuvendin e Komunës.

V. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Kryesuesi i Kuvendit të Komunës dhe Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

VI. Anëtarët e Komisionit për punën e tyre për takimet e mbajtura do të konpensohen konform dispozitave të legjislacionit në fuqi.

VII. Afati kohor për përfundimin e punëve është 6 muaj nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

VIII. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

IX. Vendimi u dërgohet kryesuesit dhe anëtarëve të Komisionit.

IX. Me këtë Vendim shfuqizohet Vendimi nr.15-020/04-40406 i datës 28.07.2022 për formimin e Komisionit për emërtimin e rrugëve të reja, shesheve dhe hapësirave publike dhe rishqyrtimin e kërkesave për riemërtimin e rrugëve në territorin e Komunës së Lipjanit.

A r s y e t i m

Baza ligjore për miratimin e këtij propozim -vendimi është e përcaktuar me dispozitat e neneve 12 dhe 17, pika o) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008 , Ligjit nr.04/L-071 për sistemin e adresave, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr.29 e datës 27 dhjetor 2011 si dhe

nenit 9 pika o) dhe 20 par 20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 të datës 24.12.2021.

Në pajtim me dispozitat e cekura ligjore emërtimi i rrugëve, shesheve, parqeve dhe zonave tjera të qarkullimit publik është kompetencë vetanake e Komunës.

Drejtorati përgjegjës është duke pranuar kërkesa të vazhdueshme të qytetarëve për emërtimin e rrugëve të reja dhe me qëllim të krijimit të adresave përkatëse në rrugët e caktuara dhe të pa emërtuara. Drejtorati përgjegjës, ka bërë analizimin e zhvillimeve hapësinore në fushen e ndërtimeve dhe vlerëson se janë zhvilluar disa rrugë të reja të cilat duhet emërtuar.

Mbi këtë bazë, është përgjegjësi ligjore e Komunës të zhvillojë procesin e emërtimit të rrugëve të reja dhe hapësirave të tjera publike në përputhje me legjislacionin përkatës.

Duke u bazuar në dispozitat e sipër cituara propozojmë miratimin e këtij Vendimi.

1Nr. 020/04-4484
Lipjan, më 28.01.2026

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

